



EUROPEAN UNION

Water and Waste Regulatory Office  
Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina  
Regulatorni Ured za Vodu i Otpad

**UNMIK**



ZRRUM – R 01 / GM

ZYRA RREGULLATIVEE PËR UJËSJELLËS DHE E MBETURINAVE  
("ZRRUM")

---

**RREGULL**

**PËR LICENCIMIN**

**E**

**OFRUESVE TË SHËRBIMIT PËR GRUMBULLIMIN E  
MBETURINAVE NË KOSOVË**

2008

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>PJESA 1 : DISPOZITAT E PËRGJITHSHME .....</b>	<b>5</b>
Kapitulli 1 : Fushëveprimi, Qëllimi dhe Përkufizimet.....	5
Neni 1 : Autoriteti për këtë Rregull .....	5
Neni 3: Qëllimi .....	5
Neni 4 : Përkufizimet .....	5
Neni 5 : Rregullat e Interpretimit.....	7
Kapitulli 2 : Dispozitat e Përgjithshme të Licencës së Shërbimit.....	8
Neni 6 : Aplikueshmëria .....	8
Neni 7 : Kohëzgjatja e Licencës së Shërbimit .....	8
Neni 8 : Numri i Licencave të Shërbimit .....	8
Neni 9: Shpenzimet për Marrjen e Licencës së Shërbimit.....	8
Neni 10 : Kufizimet.....	9
<b>PJESA 2 : APLIKACIONI PËR LICENCË TË SHËRBIMIT.....</b>	<b>9</b>
Kapitulli 1 : Procesi i Aplikimit për Licencë të Shërbimit.....	9
Neni 11 : Aplikacioni për Licencë të Shërbimit.....	9
Neni 12 : Formularët e Aplikimit për Licencë të Shërbimit .....	9
Neni 13 : Taksa për Aplikacionin e Licencës së Shërbimit .....	9
Neni 14: Aprovimi i Bordit Mbikqyrës.....	9
Neni 15: Aprovimi i Deklaratave Financiare nga AKM-ja.....	10
Neni 16 : Njoftimi me Shkrim nga Rregullatori .....	10
Neni 17 : Informatat e Përgjithshme Identifikuese .....	10
Neni 18: Zona e Shërbimit, Konsumatorët dhe Banorët që u ofrohet Shërbimi .....	10
Neni 19 : Mbeturinat e Ngurta Komunale të Grumbulluara dhe të Deponuara .....	11
Neni 20 : Kapaciteti i Grumbullimit të Mbeturinave .....	11
Neni 21 : Tarifat e Shërbimit .....	12
Neni 22: Përvoja Paraprake Operuese.....	12
Neni 23 : Pranueshmëria e Autoritetit Menagjues .....	12
Kapitulli 1 : Evidenca e Nevojshme e Dokumentuar.....	12
Neni 24 : Biografia e Menagjerëve të Lartë.....	12
Neni 25: Autorizimi nga Komuna brenda Zonës së Shërbimit.....	12
Neni 26 : Marrëveshja për Deponimin e Mbeturinave të Grumbulluara Komunale të Ngurta .....	13
Neni 27: Dokumentet e Biznesit .....	13
Neni 28 : Tatimet, Faturat e Ndërmarrjeve dhe Dokumentet që kanë të bëjnë me Detyrimet.....	15
Neni 29 : Dokumentet tjera .....	15
<b>PJESA 3: SHQYRTIMI I APLIKACIONIT DHE LËSHIMI I LICENCËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT.....</b>	<b>15</b>
Kapitulli 1: Shqyrtimi i Aplikacionit për Licencë të Shërbimit.....	15
Neni 30 : Shqyrtimi i përgjithshëm i Aplikacionit për Licencë të Shërbimit dhe dokumenteve shoqëruese .....	15
Neni 31 : Pamundësia për të ofruar informatat e kërkuara .....	16

Neni 32 :	Shqyrtimi i detajizuar i Aplikacionit për Licencë të Shërbimit .....	16
Neni 33 :	Kërkesa për informata plotësuese .....	16
Chapter 1:	Lëshimi i Licencës së Shërbimit .....	16
Neni 34 :	Lëshimi i Licencës së Shërbimit .....	16
<b>PJESA 4:</b>	<b>LICENCA E SHËRBIMIT.....</b>	<b>17</b>
Kapitulli 1 :	Përmbajtja e Licencës së Shërbimit.....	17
Neni 35 :	Përmbajtja e Licencës së Shërbimit .....	17
Kapitulli 2 :	Obligimet e Ofruesve të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave 18	
Neni 36 :	Obligimet e përgjithshme të Ofruesve të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave.....	18
Neni 37 :	Obligimet e Veçanta për të Gjithë Ofruesit e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave.....	18
Neni 38 :	Refuzimi për të lëshuar ose ripërtrirë Licencën e Shërbimit.....	19
Kapitulli 1:	Ripërtëritja ose Transferi i Licencës së Shërbimit.....	20
Neni 39 :	Ripërtëritja e Licencës së Shërbimit .....	20
Neni 40 :	Transferi i Licencës së Shërbimit.....	21
<b>PJESA 7:</b>	<b>NDRYSHIMET, PËRFUNDIMI DHE REVOKIMI I LICENCËS SË SHËRBIMIT.....</b>	<b>21</b>
Kapitulli 1:	Ndryshimet, Plotësimet ose Zëvendësimet në Kushtet e Licencës së Shërbimit.....	21
Neni 41 :	E drejta e Rregullatorit të Ndryshojë, Plotësojë ose të Zëvendësojë Kushtet e Licencës së Shërbimit .....	21
Neni 43 :	Informimi i Rregullatorit për ndryshime të rëndësishme .....	21
Kapitulli 2:	Përfundimi, Revokimi ose Dorëzimi i Licencës së Shërbimit.....	22
Neni 44 :	Përfundimi i Licencës së Shërbimit .....	22
Neni 45 :	Revokimi i Licencës së Shërbimit.....	22
Neni 46 :	Dorëzimi i Licencës së Shërbimit .....	22
<b>PJESA 8:</b>	<b>MARRËVESHJA PËR KUSHTET E LICENCËS SË SHËRBIMIT.....</b>	<b>22</b>
Neni 47 :	Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit .....	22
Neni 48 :	Negociatat e Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit... 23	
Neni 49 :	Lidhja e Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit .....	24
Neni 50 :	Karakteri Ligjor dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit .....	24
Neni 51:	Pajtueshmëria me Kushtet e Licencës së Shërbimit.....	25
<b>PJESA 9:</b>	<b>ZBATIMI, DËNIMET DHE ANKESAT.....</b>	<b>25</b>
Kapitulli 1:	ZBATIMI i Kushteve të Licencës së Shërbimit .....	25
Neni 52 :	Zbatimi i Kushteve të Licencës për Shërbimit.....	25
Kapitulli 2:	Raportet dhe Shënimet për Kushtet e Licencës për Shërbimit .....	26
Neni 53:	Shënimet dhe raportet për Kushtet e Licencës së Shërbimit.....	26
Kapitulli 3:	Kundërvajtjet dhe Dënimet.....	27
Neni 54:	Kundërvajtjet dhe Dënimet .....	27
Kapitulli 4:	Ankesat .....	27
Neni 55:	Ankesat.....	27
<b>PJESA 10:</b>	<b>TË NDRYSHME.....</b>	<b>28</b>
Neni 56 :	Gjuhët.....	28
Neni 57 :	Hyrja në Fuqi.....	28
<b>SHTOJCAT</b>	<b>.....</b>	<b>29</b>

<b>SHTOJCA 1</b> .....	<b>30</b>
FORMULARËT DHE DOKUMENTET .....	30
<b>SHTOJCA 1(A)</b> .....	<b>31</b>
FORMULARI I APLIKACIONIT PËR LICENCË TË SHËRBIMIT .....	31
<b>SHTOJCA 1(B)</b> .....	<b>35</b>
FORMULARI I LISTËS SË PAJISJEVE .....	35
<b>SHTOJCA 1 (C)</b> .....	<b>36</b>
AUTORIZIMI I BORDIT MBIKQYRËS .....	36
<b>SHTOJCA 1 (D)</b> .....	<b>37</b>
APROVIMI I DEKLARATAVE FINANCIARE.....	37
<b>SHTOJCA 1 (E)</b> .....	<b>38</b>
LETRA KONFIRMUESE NGA KOMUNA.....	38
<b>SHTOJCA 1 (F)</b> .....	<b>39</b>
LETRA AUTORIZUESE NGA KOMUNA.....	39
<b>SHTOJCA 1(G)</b> .....	<b>40</b>
LISTA KONTROLLUESE E KOMPLETIMIT .....	40
<b>SHTOJCA 1(H)</b> .....	<b>42</b>
CERTIFIKATA PËR LICENCËN E SHËRBIMIT .....	42
<b>SHTOJCA 1 (I)</b> .....	<b>43</b>
FORMATI PËR BIOGRAFINË .....	43

## **PJESA 1 : DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Kapitulli 1 : Fushëveprimi, Qëllimi dhe Përkufizimet**

#### Neni 1 : Autoriteti për këtë Rregull

Rregullatori nxjerr këtë Rregull nën autoritetin e Ligjit Mbi Veprimtarit e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe të Mbeturinave të datës 15. Qershor 2008.

#### Neni 2 : Fushëveprimi

Të gjitha Ndërmarrjet Publike që aktualisht punojnë në ofrimin e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të aplikojnë për Licencën e Shërbimit sipas dispozitave të kësaj Rregulle.

#### Neni 3: Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulle është të përcakton (vendos) procedura sipas së cilës duhet të aplikohet për dhënie, mirëmbajtjen, përtërirjen, ndryshimin dhe revokimin e Licencës së Shërbimit për Ofrimin e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave.

#### Neni 4 : Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregull do të përmbajnë kuptimet si në vijim:

“**Aplikacion**” nënkupton Aplikacionin (kërkesën) për shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave;

“**Aplikues**” nënkupton Ndërmarrjen Publike që aplikon te Rregullatori për Licencë të Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave ose për vazhdim të Licencës së Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave;

“**Banor**” nënkupton Personin që jeton ose banon në ndonjë nga Rajonet e Shërbimit;

“**Certifikata e Licencës së Shërbimit**” nënkupton certifikatën e lëshuar nga Rregullatori për Ofruesin e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave;

“**Deponia e Mbeturinave**” nënkupton vendin apo lokacionin e licencuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor për Mbeturinën e Ngurta Komunale dhe çfarëdo materie tjetër tepriçë pasi që Mbeturinën e Ngurta Komunale janë procesuar dhe kthimi i produkteve apo energjisë së shëndrrimit është arritur;

“**Ditë Pune**” nënkupton çdo ditë përveç të shtunës dhe të dielës, apo ndonjë ditë tjetër që është fest zyrtare në Kosovë;

“**Garantimi i Përmbushjes**” nënkupton instrumentin financiar që garanton përmbushjen e plotë të detyrave të Ofruesit të Shërbimeve të Ujësjetës dhe Ujërave të Zeza për të kryer Shërbimet e deponimit të Mbeturinave;

“**Komisioni Shqyrtues**” nënkupton komisionin që shqyrton vendimet e Rregullatorit, i themeluar konform Ligjit Nr.03/L-086 të datës 15 Qershor 2008;

“

**Komuna** nënkupton çdo njësi territoriale të vetëqeverisjes lokale në Kosovë që themelohet sipas Ligjit mbi Kufit Administrativ të Komunave nr.03/L-041, funksionon

në bazë të Ligjit për vetqeverisje lokale nr. 03/L-40 dhe Ligjit mbi Katastrat nr. 2003/25

**Konsumator**” nënkupton një person, që ka lidhë Kontratë Shërbimi me Ofruesin e Shërbimeve ose ka marrë shërbime të ofruara nga Ofruesi i Shërbimeve

- i. **“Konsuamtor Shtëpiak”** nënkupton Konsumatorin e klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si person i cili shfrytëzon Shërbimet në banesën ose amvisërinë e tij apo saj;
- ii **Konsumator Komercial-Industrial**” nënkupton cilindo person, subjekt ligjor ose organizatë afariste të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si Konsumator i cili shfrytëzon Shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së vet industriale apo komerciale të cilit do lloj;
- iii **“Konsumator Institucional”** nënkupton cilindo subjekt ligjor të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë të interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si oorganizatë afariste

**“Kushtet e Licencës së Shërbimit”** nënkuptojnë kushtet e veçanta nën të cilat Rregullatori i lëshon Licencën e Shërbimit një Ofruesi të Shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave;

**“Licenca e Shërbimit”** nënkupton licencën (lejen) e lëshuar nga Rregullatori konform kësaj Rregulle që autorizon Ofruesin e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave për të ofruar Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave;

**“Marrëveshja e Kushteve të Licencës për Shërbimet”** nënkupton marrëveshjen (kontratë) që mund të lidhet ndërmjet Rregullatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve që për të ndryshimin, modifikimin, ose plotësimin e çfarëdo Kushtesh të Licencës së Shërbimit në përputhje me Pjesën VIII neni 50 të kësaj Rregulle;

**“Mbeturina të Ngurta Komunale”** nënkupton mbeturinat e ngurta nga amvisëritë, burimet komerciale, institucionale ose industriale dhe mbeturinat e procesuara që nuk janë të Rrezikshme, Mjekësore apo Mbeturina Toksike;

**“Mbeturina të Rrezikshme”** nënkupton nus-produktet e shoqërisë që paraqesin rrezik substancial ose potencial për shëndetin njerëzor kur ato menaxhohen në mënyrë joadekuate. Substancat e klasifikuara si Mbeturina të Rrezikshme posedojnë sepaku një të një nga katër karakteristikat në vazhdim: janë të ndezëshme, korrozive, reaktive apo helmuese ose janë klasifikuar si të Rrezikshme sipas standardeve menaxhuese të Bashkimit Evropian për mbrojtje ambientale dhe/ose mbeturina të ngurta;

**“Mbeturina Mjekësore”** nënkupton çdo mbeturinë që paraqet rrezik specifik për shëndetin publik dhe/ose ambientin që ka origjinë nga një vend apo aktivitet ku ipet përkujdesi mjekësor dhe përfshinë mbeturinat e produkteve infektive, anatomike, të mprehta, kimike dhe farmaceutike. Çdo mbeturinë që ka origjinën nga një vend apo aktivitet i tillë i përkujdesit mjekësor që nuk paraqet rrezikun specifik të përmendur në këtë definicion, do të njihet si “Mbeturina të Ngurta Komunale”, që kanë origjinë nga lokalet komerciale;

**“Mbeturina Toksike”** nënkupton një produkt mbeturinë që mund të shkaktojë lëndime nëse thithet, gjëllitet apo absorbohet përmes lëkurës;

“ **Ndërmarrje Publike** nënkupton atë Ndërmarrje e cila është përfshirë dhe përkufizuar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L087 dhe që funksionon në bazë të këtij Ligji dhe Ligjit për Shoqërit tregëtare Nr.02/L-123

“**Ofrues i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave**” nënkupton secilin Person që ofron apo ka për qëllim të ofrojë Shërbim të Grumbullimit të Mbeturinave;

“**Person**” nënkupton një individ, legal apo publik përfshirë korporatë, ortakëri, trust, një organizatë të inkuorporuar, qeveri apo agjenci ose nënsektor;

“**Plani i Konsolidimit**” nënkupton planin e ristrukturimit të sektorit i cili është krijuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (“AKM”) për konsolidimin dhe ristrukturimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës dhe Mbeturinave të datës 10 Shtator 2002 dhe të ndryshuar, plotësuar ose zëvendësuar kohë pas kohe nga AKM apo institucioni pasues i saj;

“**Regjion**” nënkupton një rajon të definuar nga Plani i Konsolidimit që përfshin një Komunë dhe tërsinë apo një pjesë të Komunave tjera;

“**Rregullator**” nënkupton autoritetin përgjegjës për rregullimin ekonomik të Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës dhe Ujërave të Zeza nën ligjin e aplikueshëm gjithashtu që na referohet neve si “Zyra Rregullative për Ujësjetës dhe Mbeturina (“ZRRUM”) apo organizata e saj pasardhëse;

“**Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave**” nënkuptojnë deponimin e Mbeturinave të Ngurta Komunale në Deponinë e Mbeturinave;

“**Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave**” nënkuptojnë grumbullimin e Mbeturinave Komunale dhe transportimin e tyre deri te Deponia e Licencuar;

“**Standardet e Shërbimit**” nënkupton standardet që aplikohen ndaj atij Shërbimi në përputhje me Rregullën e Standardeve të Shërbimit dhe nivelin minimal të standardeve që aplikohen ndaj atij shërbimi të përcaktuara nga Rregullatori në Kushtet e Licencës së Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave;

“**Taksa Vjetore e Licencës**” nënkupton taksën që duhet ti paguhet Rregullatorit çdo vit nga të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave me qëllim që të mundësohet gëzimi i të drejtave të dhëna nga Rregullatori në lidhje me ofrimin e shërbimeve

“**Tarifat e Shërbimeve**” nënkupton secilën vlerë, çmim ose taksë të Ofruesit të Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave;

“**Tarifat e Shërbimit**” nënkuptojnë çdo ngarkesë, taksë apo çmim të Ofruesit të Shërbimeve në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të tija për Konsumatorët;

“**Zona e Shërbimit**” nënkupton, rajonin apo Komunën në të cilin Ofruesi Përkatës i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave është i autorizuar të ofrojë shërbimet e tij;

#### Neni 5 : Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregull:

- (a) Cilatdo fjalë dhe shprehje të përdorura në këtë Rregull, që nuk janë veçanërisht të definuara këtu dhe për të cilat mund të bëhet fjalë, duhet të përmbajnë kuptimet siç janë të përcaktuara në aktet ligjore që i referohen

Hyrjes së kësaj Rregulle dhe/ose cilitdo tjetër ligj të aplikueshëm në Kosovë; dhe

- (b) Referencat në Rregullë do të interpretohen sipas kuptimit cilëndo Rregull të të lëshuar, modifikuar, ndryshuar, plotësuar, dhe/ose zëvendësuar nga Rregullatori kohë pas kohe në pajtim me kompetencat që i janë dhënë Rregullatorit; dhe
- (c) Njëjësi përfshinë shumësin dhe anasjelltas; dhe
- (d) Fjalët e njerës gjini do të përfshijnë gjinin tjetër; dhe
- (e) Referencat për Pjesët, Kapitujt, dhe Nenet, përveç nëse qëllimisht nuk caktohet ndryshe, janë referenca për Pjesë, Kapituj dhe Nene të këtij Rregulli.

## **Kapitulli 2 : Dispozitat e Përgjithshme të Licencës së Shërbimit**

### Neni 6 : Aplikueshmëria

Të gjitha Ndërmarrjet në Pronësi Publike që ofrojnë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave të ngurta komunale në Kosovë janë të obliguar që të aplikojnë dhe të marrin Licencë të Shërbimit nga Rregullatori sipas dispozitave të kësaj rregulle për shërbimet e grumbullimit, largimit dhe transportimit deri në Deponi

### Neni 7 : Kohëzgjatja e Licencës së Shërbimit

Të gjitha Licencat e Shërbimit dotë lëshohen për një kohëzgjatje jo më pak se një (1) viti dhe jo më shumë se pesë (5) vite.

### Neni 8 : Numri i Licencave të Shërbimit

Numri i Licencave të Shërbimit të cilat do të lëshohen nga Rregullatori duhet të kenë kufizimet si në vijim:

- (a) Nuk duhet të lëshohet më shumë se një (1) Licencë e Shërbimit për një Ofrues të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave.
- (b) Rregullatori, nëse mendohet se një gjë e tillë është në interes të përgjithshëm, mund të lëshojë Licencën e Shërbimit për më shumë se një Ofrues të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave përbrenda kufijve zyrtare të një Komune.
- (c) Rregullatori, nëse mendohet se një gjë e tillë është në interes të përgjithshëm, mund të lëshojë Licencën e Shërbimit për të cilën Zona e Shërbimit mbulon më shumë se një Komunë në tërësi ose pjesërisht, tek Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave i identifikuar në Planin e Konsoliduar që ka Kompetencë Menagjimi mbi Ofruesit tjerë të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave

### Neni 9: Shpenzimet për Marrjen e Licencës së Shërbimit

- 9.1 Të gjitha shpenzimet lidhur me aplikimin për dhe/ose për marrjen e Licencës së Shërbimit, duke përfshirë edhe Taksën për të Aplikuar për Licencën e Shërbimit e shtjelluar në Neni 13, duhen të jenë në përgjegjësi e vetme e Aplikuesit për Licencës së Shërbimit.



- 9.2 Në Tarifën e Shërbimit Ofruesi i Shërbimit duhet të përfshijë shumën e Taksës që paguan për Licencën e Shërbimit.

#### Neni 10 : Kufizimet

- 10.1 Licenca e Shërbimit e lëshuar nga Rregullatori duhet të përdoret vetëm me qëllim të grumbullimit dhe të largimit të Mbeturinave të Ngurta Komunale dhe transportit të tyre në Kompleksin e Deponisë së Licencuar të përcaktuar në Licencën e Shërbimit.
- 10.2 Aktivitetet në vijim sa i përket grumbullimit, transportimit dhe depozitimit të:
- (a) Mbeturinave të Lëngëta; dhe/ose
  - (b) Mbeturina Medicinale dhe Patologjike; dhe/ose
  - (c) Mbeturina Toksike dhe të Rrezikshme

nuk mund të zbatohen sipas kushteve të dala nga kjo Rregull për dhënien e Licencës së Shërbimit por kërkojnë dhe duhet të iu nënshtrohen kushteve licencuese specifike për secilën prej këtyre aktiviteteve të cilat do të nxirren nga Rregullatori i cili mund(do) të i përcaktojë kohë pas kohe.

## **PJESA 2 : APLIKACIONI PËR LICENCË TË SHËRBIMIT**

### **Kapitulli 1 : Procesi i Aplikimit për Licencë të Shërbimit**

#### Neni 11 : Aplikacioni për Licencë të Shërbimit

Të gjithë Ndërmarrjet Publik që ofrojnë shërbime të Grumbullimit të Mbeturinave, duhet të parashtrojnë Aplikacionin e kompletuar për Licencë në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulle tek Rregullatori

#### Neni 12 : Formularët e Aplikimit për Licencë të Shërbimit

Të gjitha Aplikacionet për Licencë të Shërbimit duhet të dorëzohen në tri kopje te Rregullatori (një origjinal dhe dy kopje) sipas udhëzimeve të dhëna në Aplikacionin e Licencës së Shërbimit të përfshirë në Shtojcën 1(A) në këtë Rregull.

#### Neni 13 : Taksa për Aplikacionin e Licencës së Shërbimit

- 13.1 Aplikuesi për Licencë të Shërbimit duhet të paguajë në tërësi në të holla të gatshme Taksën e pakthyeshme të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit, te Rregullatori në të njejtën kohë kur të dorëzohet Aplikacioni për Licencë të Shërbimit.
- 13.2 Rregullatori pas konsultimeve me Kuvendi i Kosovës dhe Ministrin e Ekonomisë dhe të Financave nxjerr udhëzimin administrativ në të cilën saktësohet shuma e Taksës për Aplikim për Licencë të Shërbimit të pagueshme sipas këtij Neni.

#### Neni 14: Aprovimi i Bordit të Drejtorve

- 14.1 Aplikacioni për Licencë të Shërbimit duhet të aprovohet nga Bordi i Drejtorve.
- 14.2 Aprovimi i Bordit të Drejtorve i përcaktuar në nën-nenin 14.1, duhet të ipet në formë të dokumentit ,sipas përmbajtjes dhe formatit të ofruar në Shtojcën 1(C) dhe duhet të i bashkangjitet Aplikacionit për Licencë të Shërbimit

Neni 15: Aprovimi i Deklaratave Financiare nga AKM-ja apo instutcioni pasardhës i saj

- 15.1 Zyrtari i lartë financiar i AKM-së ose Personi i cili ka mandat dhe është i autorizuar për këtë qëllim nga AKM-ja apo instutcioni pasardhës i saj, duhet të aprovojë të gjitha deklaratat financiare të dorëzuara nga Aplikuesi për Licencën e Shërbimit të Rregullatorit me qëllim të marrjes së Licencës së Shërbimit.
- 15.2 Aprovimi i deklaratës financiare e cila duhet të i bashkangjitet Aplikacionit për Aplikacionit për Licencë të Shërbimit duhet të jetë në formë të dokumentit të nënshkruar nga zyrtari i lartë financiar i autorizuar ose nga Personi tjetër që ka autorizim, sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1(D) të kësaj Rregulle.

Neni 16 : Konfirmim me Shkrim nga Rregullatori

- 16.1 Rregullatori, duhet ti lëshojë Aplikuesit të Licencës për Shërbime një konfirmim me shkrim për pranimin e aplikacionit, dokumenteve përcjellëse dhe të datës së pranimit të tyre, jo më vonë se pesë (5) Ditë Pune nga pranimi i aplikacionit.
- 16.2 Konfirmimi me Shkrim për pranimin e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit nuk duhet të detyrojë Rregullatorin për sa i përket miratimit, përmbushjës dhe aprovimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit nga ana e tij.
- 16.3 Rregullatori duhet të dërgojë dëftesën në shumën që është e barabartë me Taksën e Aplikim për Licencë të Shërbimit Aplikuesi për Licencë të Shërbimit.

Neni 17 : Informatat e Përgjithshme Identifikuese

Aplikuesi i Licencës për Shërbim duhet të sigurojë në pjesën përkatëse të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit, informatat e përgjithshme identifikuese si në vijim si dhe informatat tjera që mund të caktohen në Aplikacion të Licencës së Shërbimit (Shtojca1A, pjesa1, 2 dhe 3):

- (a) Identifikimi i Aplikuesit për Licencë të Shërbimit: Adresën e tanishme e plotë postale të selisë së biznesit ose zyres së regjistruar, duke përfshirë numrat e telefonit, numrin e faksit dhe adresën elektronike; dhe
- (a) Kontakt personi i Aplikuesit: Emri i plotë dhe kontakt detajet e personit i cili është i autorizuar të përgadisë dhe hartojë Aplikacionin, me të cilin Rregullatori mund ta kontaktoj për ndonjë pyetje lidhur me Aplikacionin;
- (c) Njoftimi i Menaxherëve të Lartë: Emrat dhe adresat e Kryesuesit të Bordit të Drejtorve, Drejtorit Administrativ ose Menaxherin Kryesor sipas sistemimit, Zyrtari i Lartë Financiar, Menaxheri i Lartë Operativ, Menaxheri për Shërbime të Konsumatorëve.

Neni 18: Zona e Shërbimit, Konsumatorët dhe Banorët që u ofrohet Shërbimi

Aplikuesi i Licencës së Shërbimit duhet në pjesën përkatëse të Aplikacionit për Licencë të ofrojë informatat për Zonën e Shërbimit, Konsumatorët dhe Banorët si në vijim(shtojca1 A, pjesa 4 dhe 5):

- (a) Identifikimi i Zonës së Shërbimit: Zona e Shërbimit, duke përfshirë emrin(at) e Komunës(ave) dhe kufijtë gjeografik të saj ku ofrohet shërbimi më datën e parashtrimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit

- (b) Fshatrat dhe Vendbanimet: Duhet të sigurohen emrat e fshatrave dhe vendbanimeve që u ofrohen shërbimet në datën e parashtrimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit; dhe
- (c) Konsumatorët e Shërbyer: një vlerësim të numrit të Konsumatorëve që u ofrohet shërbimi nga parashtruesi i Aplikacionit për Licencë të Shërbimit në kohën e parashtrimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit dhe e ndarë në kategoritë si në vijim:
  - (i) Konsumatorë Shtëpiak;
  - (ii) Konsumatorët Komercial dhe Industrial (duke përfshirë Ndërmarrjet Shoqërore);
  - (iii) Institucionet qeveritare dhe publike;
- (d) Banorët që u ofrohet shërbimi: Një vlerësim i numrit total të banorëve në Zonën e Shërbimit, numri i fshatrave rurale që marrin Shërbimin dhe vlerësimin se sa prej tyre janë duke e shfrytëzuar ose do ta shfrytëzojnë Shërbimin e grumbullimit të Mbeturinave në periudhën e ardhshme dymbëdhjetë (12) mujore.

Neni 19 : Mbeturinat e Ngurta Komunale të Grumbulluara dhe të Deponuara

Aplikuesi për Licencë të Shërbimit që nga data e parashtrimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit duhet të ofrojë në pjesën përkatëse të formularit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit informatat si në vijim (Shtojca 1A pjesa 6):

- (a) Sasinë e grumbulluar të Mbeturinave të Ngurta Komunale: Sasinë e Mbeturinave të Ngurta Komunale të grumbulluar për çdo ditë nga Aplikuesi i Licencës së Shërbimit, Sasia që paraqitet, duhet të përcaktohet sipas peshës në ton ose vëllim (metër kub) të grumbulluar për tetë (8) orë të punës së ndërrimit; dhe.
- (b) Deponia e Licencuar: Emri(at) e Deponisë së Licencuar në shfrytëzim nga Aplikuesi për Licencë të Shërbimit për hudhjen e Mbeturinave të Ngurta Komunale të grumbulluara. Gjithashtu duhet të ofrohet numri i ngarkesave të Mbeturinave të Ngurta Komunale të transportuara në secilën Deponi të Licencuar.

Neni 20 : Kapaciteti i Grumbullimit të Mbeturinave

Aplikuesi i Licencës së Shërbimit duhet të ofrojë në pjesën përkatëse të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit informatat nga data e parashtrimit, si në vijim (Shtojca 1A pjesa 7):

- (a) Të punësuarit: Numri total i të punësuarve me orar të plotë, si dhe Numri i të punësuarve që janë të angazhuar në Shërbimin të Grumbullimit të Mbeturinave sipas kategorive të shënuara në formularin e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit;
- (b) Pajisjet për Grumbullimin e Mbeturinave: Përmbledhja e emrave dhe llojit të pajisjeve dhe makinerive të dedikuara për kryerjen e Shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave sipas kategorive të shënuara në formularin e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit; dhe
- (c) Pajisjet Përkrahëse: Lista e pajisjeve dhe makinerive duke përfshirë aftësitë mekanike të mirëmbajtjes të shfrytëzuara për mbështetjen e Shërbimit të

Grumbullimit të Mbeturinave sipas kategorive e dhënë në formularin e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit.

#### Neni 21 : Tarifat e Shërbimit

Aplikuesi i Licencës së Shërbimit duhet të ofrojë në pjesën përkatëse të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit listën e Tarifave të ndryshme në fuqi nga data e parashtrimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit për ofrimin e Grumbullimit të Mbeturinave.

#### Neni 22: Përvoja Paraprake Operuese

- 22.1 Aplikuesi i Licencës së Shërbimit në pjesën përkatëse të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit duhet të ofrojë përshkrim të përmbledhur që demonstron qartë përvojën e tij në ofrimin e Shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave të dhënë në Shtojca 1A pjesa 8.
- 22.2 Informatës në lidhje me përvojën paraprake të Aplikuesit për Licencë të Shërbimit duhet ti shtohen biografia e secilit anëtarë të stafit të emëruar në Seksionin 24 e kësaj Rregulle.

#### Neni 23 : Pranueshmëria e Autoritetit Menagjues

Aplikuesi i Licencës së Shërbimit, nëse është e zbatueshme, në Kërkesën për Licencë të Shërbimit duhet të shënojë emrat e të gjithë Ofruesve të Shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave, që sipas Planit të Konsolidimit, duhet të jetë nën Autoritetin e tij Administrativ në lidhje me ofrimin e Shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave në cilindo sektor gjeografik përbrenda Zonës së Shërbimit.

### **Kapitulli 1 : Evidenca e Nevojshme e Dokumentuar**

#### Neni 24 : Biografia e Menagjerëve të Lartë

- 24.1 Aplikuesi i Licencës së Shërbimit së bashku me Aplikacionin për Licencë të Shërbimit duhet të parashtrijë biografinë për secilin Menagjer të lartë si në vijim:
  - (a) Kryesuesin e Bordit të Drejtorëve
  - (b) Drejtorin Menagjues ose Menagjerin e Përgjithshëm sipas rastit;
  - (c) Drejtorin ose Menagjerin e Lartë Financiar;
  - (d) Drejtorin ose Menagjerin e grumbullimit të Mbeturinave të Ngurta; dhe
  - (e) Drejtorin ose Administratorin e Shërbimit të Konsumatorëve.
- 24.2 Biografia e secilit prej udhëheqësve të lartë të përmendur në nenin 24. pika 1 të Aplikuesit për Licencë të Shërbimit duhet të dorëzohet në formën e dhënë sipas Shtojcës 1(I) të këtij Rregulli.

#### Neni 25: Autorizimi nga Komuna brenda Zonës së Shërbimit

- 25.1 Aplikuesi i Licencës së Shërbimit me Aplikacionin për Licencë të Shërbimit duhet të dorëzojë dëshminë e dokumentuar se Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave që aplikon për Licencë të Shërbimit ka autorizimin e duhur të bëjë grumbullimin e Mbeturinave të Ngurta Komunale në Komunë ose Komunitat brenda

kufijve gjeografik të Zonës së Shërbimit të cilave iu referohet Aplikacioni për Licencë të Shërbimit.

25.2 Dëshmia e dokumentuar e kërkuar në nenin 25.pika 1 të lartpërmendur mund të paraqitet në formë të:

- (a) Ndonjë marrëveshje ekzistuese me Komunën ose Komunat përkatëse e cila dëshmon qartë se Aplikuesi i Licencës së Shërbimit është i autorizuar të grumbullojë, largojë dhe transportojë Mbeturinat e Ngurta Komunale brenda tërë ose një pjese të kufijve teritorial të asaj Komune ose Komunave. Nëse autorizimi është i vlefshëm vetëm për një pjesë të territorit të Komunës ose Komunave të përmendura përshkrimi gjeografik i Zonave të Shërbimit i autorizuar duhet në mënyrë të qartë të figurojë në marrëveshje; dhe
- (b) Vërtetimi nga Kryetari i Komunës se Aplikuesi për Licencë ka ofruar Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave për Komunën për disa vite ose gjithmonë e ka bërë atë, i evidentuar në formë të dokumentit të plotësuar në pajtim me formën standarde të ofruar në shtojca 1(E) të kësaj Rregulle.

#### Neni 26 : Marrëveshja për Deponimin e Mbeturinave të Grumbulluara Komunale të Ngurta

26.1 Aplikuesi i Licencës së Shërbimit së bashku me Aplikacionin për Licencë të Shërbimit duhet të dorëzojë, dëshminë e dokumentuar se ai ka lidhur marrëveshje me Deponinë e Licencuar dhe është i autorizuar të sjellë Mbeturinat e Ngurta Komunale të grumbulluara në atë objekt për deponim. Veç kësaj, marrëveshja qartazi duhet të paraqes taksat e deponimit ose huthjes me të cilat ngarkohet Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave nga Ofruesi i Shërbimit të Deponimit të Mbeturinave.

26.2 Marrëveshja që i referohet nenit 26. pika 1 mund të dëshmojë me(Shtojca 1G3.):

- (a) Një kopje të kontratës ose marrëveshjes në mes të Ofruesit të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave dhe operuesin e Kompleksit të Deponisë së Licencuar;
- (b) Një kopje të letrës së lëshuar në formën si në Shtojcën 1(F) të kësaj Rregulle e nënshkruar nga Kryetari i Komunës në të cilën Kompleksi i Deponisë së Licencuar ndodhet, që demonstroi qartë se Aplikuesi i Licencës është i autorizuar të sjellë dhe shkarkojë Mbeturinat e Ngurta Komunale të grumbulluara në Zonën e Shërbimit tek Kompleksi i Deponisë së Licencuar dhe gjithashtu konfirmimin e pagesës së taksës nga Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave që është i autorizuar të bëjë këtë. Sipas kësaj, të shfytëzohet kopja e letrës dhe formati; dhe/ose
- (c) Cilido dokument tjetër i lëshuar nga autoriteti përgjegjës në të cilën qartë demonstron se Aplikuesi i Licencës për Shërbimit është i autorizuar të ofrojë Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave në Zonën e Shërbimit në të cilën aplikohet për Licencë të Shërbimit. dhe është i autorizuar të sjellë dhe shkarkojë Mbeturinat e Ngurta Komunale të grumbulluara në kompleksin e objektit të Deponisë së Licencuar

#### Neni 27: Dokumentet e Biznesit

Aplikuesi i Licencës së Shërbimit së bashku me Aplikacionin për Licencë të Shërbimit duhet të dorëzojë dokumentet e biznesit si në vijim:

- (a) Dëshminë e dokumentuar se Aplikuesi i Licencës së Shërbimit është i autorizuar nga Bordi i Drejtorve të aplikojë për Licencë të Shërbimit (Shtojca 1C).
- (b) Një kopje të statutit ose dokumenteve të themelimit që ligjërisht themelojnë ose inkorporojnë Aplikuesin e Licencës së Shërbimit;
- (c) Organogramin e organizatës që tregon dhe klasifikon të gjitha nivelet e funksioneve duke filluar nga niveli i Bordit të Drejtorve.
- (d) Një kopje të Çertifikatës për Regjistrimin e Biznesit në fuqi dhe valide e lëshuar nga organet gjegjëse (Ministria për tregëti dhe industri) për Aplikuesin e Licencës së Shërbimit;
- (e) Një kopje të Çertifikatës për Regjistrimin e TVSH-së e lëshuar për Aplikuesin e Licencës së Shërbimit;
- (f) Konfirmim me shkrim nga Zyrtari i Lartë Financiar i Aplikuesit për Licencë të Shërbimit se të gjitha pagat e punëtorëve janë paguar në mënyrë të rregulltë sipas marrëveshjes me punëtorët e përmendur; dhe se tatimi mbi të ardhurat dhe pensionet e paguara të mbajtura nga punëdhënësi në emër të punëtorëve janë dërguar në autoritetet e caktuara fiskale të Kosovës;
- (g) Një kopje të kompletit të fundit të deklaratave financiare, të audituara nëse janë në dispozicion. Deklaratat financiare duhet të mbulojnë komplet periudhën fiskale duke i paraprirë datës në të cilën është dorëzuar Kërkesa për Licencë të Shërbimit, si dhe deklarata financiare për secilin muaj duke mbuluar periudhën që fillon në ditën e parë të muajit duke vazhduar deri në fund të periudhës së përmendur fiskale deri në ditën e fundit të muajit që i paraprinë asaj gjatë së cilës është dorëzuar Kërkesa për Licencë të Shërbimit te Rregullatori;
- (h) Nëse Aplikuesi i Licencës së Shërbimit është, shoqëri aksionare (tregtare), deklaratat financiare duhet të certifikohen nga Kryesuesi i Bordit dhe nga Drejtori Administrativ dhe Zyrtari i Lartë Financiar dhe gjithashtu nga AKM-ja nëse Aplikuesi i Licencës së Shërbimit është nën mbikqyrjen Administrative të AKM apo të institucioneve pasardhës të saj;
- (i) Një kopje e deklaratës bankare për të gjitha llogaritë bankare të Aplikuesit për Licencë të Shërbimit për periudhën që mbulon gjashtë (6) muaj në tërësi duke i paraprirë datës në të cilën është dorëzuar Kërkesa për Licencë të Shërbimit;
- (j) Dëshmi e “sigurisë së përgjithshme dhe të plotë të detyrimeve publike” e kërkuar si vijim i Rregullës mbi “Standardet e Shërbimit për Ofruesit e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave të Ngurta në Kosovë” e lëshuar, ndryshuar ose e plotësuar kohë pas kohe nga Rregullatori; dhe
- (k) Dëshmi e instrumenteve financiare të garancës në lidhje me kryerjen e punëve, e kërkuar si vijim i Rregullës mbi “Standardet e Shërbimit për Ofruesit e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave të Ngurta në Kosovë” e lëshuar, ndryshuar ose e plotësuar kohë pas kohe nga Rregullatori.

Neni 28 : Tatimet, Faturat e Ndërmarrjeve dhe Dokumentet që kanë të bëjnë me Detyrimet

Aplikuesi i Licencës së Shërbimit së bashku me Kërkesën për Licencë të Shërbimit duhet të parashtrijë dokumentet e ndërmarrjeve publike si dhe dokumentet që kanë të bëjnë me tatimet, si vijon (Shtojca 1 G.3):

- (a) Dëshmia e dokumentuar që demonstroi qartë se Aplikuesi i Licencës është i rregullt në shlyerjen e detyrimeve të tij ndaj Tatimit mbi Pronën. Dëshmia e dokumentuar duhet të jetë në formë të faturës së vulosur “e paguar në tërësi” të Tatimit mbi Pronën nga zyrtari i autorizuar i Komunës ku ndodhet Aplikuesi për Licencë të Shërbimit. Në rast se Aplikuesi për Licencë nuk është i rregullt në lidhje me detyrimet e tij për Tatimin mbi Pronën, duhet të ofrohet shpjegimi dhe arsyet, shuma e borxhit si dhe përshkrimi i masave korrektuese që duhet të ndërmerren.
- (b) Dëshmia e dokumentuar duhet të jetë në formë të letrës së vulosura me “të paguara në tërësi që demonstroi qartë se Aplikuesi për Licencë të Shërbimit është i rregullt në pagesat e faturave të ujit, rrymës elektrike dhe telefonit në momentin e dorëzimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit. Në rast se Aplikuesi i Licencës së Shërbimit nuk është i rregullt në pagesat e faturave të ndërmarrjeve publike, duhet të ofrohet shpjegimi dhe arsyet, shuma e borxhit si dhe përshkrimi i masave korrektuese që duhet të ndërmerren.
- (c) Dëshmia e dokumentuar që demonstroi qartë se Aplikuesi i Licencës së Shërbimit është i rregullt në shlyerjen e detyrimeve që kanë të bëjnë me TVSH-në, tatimin mbi të hyrat dhe tatimet tjera të definuara me ligj që janë të përcaktuara dhe të pagueshme. Në rast se Aplikuesi i Licencës së Shërbimit nuk është i rregullt në shlyerjen e detyrimeve që kanë të bëjnë me tatimet duhet të ofrohet shpjegimi dhe arsyet, shuma e borxhit si dhe përshkrimi i masave korrektuese që duhet të ndërmerren.

Neni 29 : Dokumentet tjera

Aplikuesi i Licencës së Shërbimit gjithashtu së bashku me Aplikacionin për Licencë të Shërbimit duhet të dorëzojë hartën e Zonës së Ofrimit të Shërbimit me perimetrin e asaj zone qartë të identifikuar në të.

**PJESA 3: SHQYRTIMI I APLIKACIONIT DHE LËSHIMI I LICENCËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT**

**Kapitulli 1: Shqyrtimi i Aplikacionit për Licencë të Shërbimit**

Neni 30 : Shqyrtimi i përgjithshëm i Aplikacionit për Licencë të Shërbimit dhe dokumenteve shoqëruese

Rregullatori duhet të kompletojë shqyrtimin e përgjithshëm të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit të parashtruar me dokumente të bashkangjitura, si në vijim:

- (a) Rregullatori duhet të sigurojë se Aplikacioni për Licencë të Shërbimit e dorëzuar nga Aplikuesi i Licencës së Shërbimit është i kompletuar me informata dhe dokumente e kërkuara dhe të regjistrojë rezultatet e

shqyrtimit të përgjithshëm të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit në formën që është e paraqitur në Shtojcën 1(G) në këtë Rregull;

- (b) Rregullatori duhet të informojë me shkrim Aplikuesin e Licencës së Shërbimit brenda tridhjetë (30) ditëve të punës për cilëndo informat apo dokument që mungon ose është e pakompletuar dhe që Aplikacioni për Licencë të Shërbimit do të mbahet pezull përderisa të ofrohen ato dokumente ose informata të kërkuara për një periudhë që nuk tejkalon tridhjetë (30) ditë të punës nga data e parashtrimit të kërkesës, pas të cilës datë Aplikacionit për Licencë të Shërbimit do ti kthehen Aplikuesit për Licencë të Shërbimit. Në rast se ndodhë një gjë e tillë shuma e plotë e Taksës e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit do të konfiskohet dhe do të ngel tek Rregullatori.

#### Neni 31 : Pamundësia për të ofruar informatat e kërkuara

Aplikuesi i Licencës së Shërbimit në kërkesë nga Rregullatori duhet të ofrojë arsyetimin me shkrim lidhur me pamundësinë e tij të ofrojë cilëndo prej informatave dhe dokumenteve të kërkuara që duhet të shoqërojnë Aplikacionin për Licencë të Shërbimit dhe të ofrojë planin e afatizuar të veprimit për të kompletuar dhe me masat korrektuese për korrigjimin e situatës.

#### Neni 32 : Shqyrtimi i detajizuar i Aplikacionit për Licencë të Shërbimit

Në rast se Aplikacioni për Licencë të Shërbimit konsiderohet si i pranueshëm, Rregullatori duhet të vazhdojë të zbatojë dhe kompletojë brenda tridhjetë (30) ditëve të punës një shqyrtim objektiv teknik lidhur me:

- (a) Saktësinë dhe tërësinë e informatave të ofruara në Aplikacion për Licencë të Shërbimit dhe në dokumentet përkatëse shoqëruese;
- (b) Kapaciteti i menaxhmentit dhe aftësia operative e Aplikuesit të Licencës së Shërbimit për të ofruar Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave me kualitet të nivelit të pranueshëm, me besueshmëri dhe siguri të duhur për një kosto të përballueshme ndaj Konsumatorëve për kushtet ekonomike ekzistuese në Kosovë;
- (c) Kapaciteti financiar i Aplikuesit për Licencë të Shërbimit nga aspekti i mirëmbajtjes dhe vazhdimit të punës për periudhën që do të mbulohet nga Licenca për Shërbim; dhe
- (d) Vlerësimi i efekteve të dhënies së Licencës të Shërbimit që ndërlidhen me mungesën e cilitdo dokumenti ose informate që mungon si dhe masat korrektuese të propozuara në Nenin 31.

#### Neni 33 : Kërkesa për informata plotësuese

Aplikuesi i Licencës së Shërbimit duhet të bashkëpunojë në mënyrë të plotë me Rregullatorin që me përpikëri të ofrojë cilatdo informata dhe dokumente shtesë që arsyeshëm kërkohen nga Rregullatori për të vlerësuar në mënyrë të duhur Aplikacionin për Licencë të Shërbimit.

## **Kapitulli 2: Lëshimi i Licencës së Shërbimit**

#### Neni 34 : Lëshimi i Licencës së Shërbimit



34.1 Rregullatori do të lëshojë Licencën e Shërbimit për Aplikuesin e suksesshëm të Licencës së Shërbimit brenda tridhjetë (30) ditëve të punës nga data në të cilën është kompletuar shqyrtimi i detajizuar dhe rezultatet e shqyrtuara të jenë vlerësuar se arsyetojnë lëshimin e Licencës së Shërbimit.

- (a) Ka paguar taksën e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit;
- (b) Ka parashtruar formularin e kompletuar për Aplikacion për Licencimin e Shërbimit dhe dokumentet tjera të kërkuara;
- (c) Ka demonstruar gjatë procesit të Aplikimit të Licencës së Shërbimit se ka ndershmëri financiare dhe kapacitet teknik dhe ekonomik për të mirëmbajtur dhe vazhduar punën në nivel që kërkohet në Kushtet e Licencës së Shërbimit;
- (d) Ka demonstruar gjatë procesit të Aplikimit të Licencës së Shërbimit se ka zotësitë elementare dhe përvojën për të ofruar Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave me Standardet Minimale për ofrimin e Shërbimit të kërkuara në Kushtet e Licencimit të Shërbimit; dhe
- (e) Ka demonstruar gjatë procesit të Aplikimit të Licencës së Shërbimit se ka paisje adekuate dhe burime adekuate për mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre për të ofruar më tutje Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave me Standardet minimale të Shërbimit siq kërkohet në Kushtet e Licencimit të Shërbimit.
- (f) Ka marrë të gjitha lejet e nevojshme, pëlqimet dhe autorizimet tjera ashtu siq kërkohet nga autoritetet e caktuara dhe është në pajtim me kërkesat e këtyre lejeve, pëlqimeve dhe autorizimeve;

#### 34: Afati i Licencës së Shërbimit

Licencat e Shërbimit do të lëshohen për një kohëzgjatje të caktuar, jo më pak se një (1) viti dhe jo më shumë se pesë (5) viteve.

### **PJESA 4: LICENCA E SHËRBIMIT**

#### **Kapitulli 1 : Përmbajtja e Licencës së Shërbimit**

##### Neni 35 : Përmbajtja e Licencës së Shërbimit

Të gjitha Licencat e Shërbimit të lëshuara nga Rregullatori duhet të specifikojnë ose të përfshijnë së paku sa vijon:

- (a) Certifikatën për Licencë të Shërbimit;
- (b) Kohëzgjatjen për të cilin është lëshuar Licenca e Shërbimit;
- (c) Emrin e Komunës(ave) që duhet të u ofrohen Shërbimet, identifikimi i Zonave të Shërbimit si dhe përshkrimin e kufive gjeografik të Zonës së Shërbimit;
- (d) Emrin e Kompleksit të Deponisë së Licencuar në të cilën Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave është i autorizuar të transportojë dhe të shkarkojë Mbeturinat e Ngurta Komunale të grumbulluara;

- (e) Taksa për Licencën e Mirëmbjatjes së Shërbimit duhet të paguhet nga Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave sipas kushteve të pagesës;
- (f) Përshkrimi i llojit të Mbeturinave të Ngurta Komunale për të cilat Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave do të jetë i autorizuar ti grumbullojë, largojë dhe transportojë;
- (g) Minimumi i Standardeve të Shërbimit në lidhje me nivelin e Shërbimit që do të kërkohet nga Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave që të mirëmbajë dhe të ofrojë duke u bazuar në Rregullin “Mbi Standardet e Shërbimit mbi Grumbullimin e Mbeturinave” e lëshuar, ndryshuar ose e plotësuar kohë pas kohe nga Rregullatori;
- (h) Kërkesat elementare të raportimit dhe obligimin për shpalosjen e informatave të cilat do të kërkohen të zbatohen dhe ofrohen nga Ofruesin e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave për Rregullatorin që ky i fundit mund të i përcaktoj kohë pas kohe;
- (i) Listën e paisjeve të autorizuara për Ofruesin e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave për të operuar nën kushtet e Licencës së Shërbimit;
- (j) Deklaratën që konfirmon se nga Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave do të kërkohet të pranojë përgjegjësinë e përgjithshme për ofrimin e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave në Zonën e Shërbimit të mbuluar nga Licenca e tij e Shërbimit;
- (k) Deklarata që konfirmon se Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave është përgjegjës për kordinimin dhe menagjimin e operimeve të Ofruesve të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave të përcaktuar me Plani i Konsoliduar që do të jenë nën Autoritetin e Administrimit të tij brenda Zonës së Shërbimit;
- (l) Identifikimi i Ofruesve të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave të cilët vëhen nën përgjegjësinë e përgjithshme dhe nën Autoritetin e Administrimit të Ofruesit të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave; dhe
- (m) Deklarata që konfirmon se Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të sigurojë standardizimin gradual të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave të ofruara në të gjitha zonat e përfshira brenda Zonës së Shërbimit duke deklaruar se një gjë e tillë është teknikisht dhe financiarisht e realizueshme.

## **Kapitulli 2 : Obligimet e Ofruesve të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave**

### Neni 36 : Obligimet e përgjithshme të Ofruesve të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave

Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave është i obliguar të iu përshtatet të gjitha Kushteve të përgjithshme Licencuese të Shërbimit që janë të shënuara në Licencën e Shërbimit dhe cilatdo kushteve specifike shtesë të cilat mund të kërkohen nga Rregullatori në Licencën e Shërbimit.

### Neni 37 : Obligimet e Veqanta për të Gjithë Ofruesit e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave

- 37.1 Licenca e Shërbimit e lëshuar nga Rregullatori duhet qartë të identifikojë obligimet e veçanta të Ofruesit të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave si vijon:
- (a) Të ofrojë dhe të mirëmbajë Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave në nivel me Rregullin “Mbi Standardet e Shërbimit për Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave” të vendosura, ndryshuara dhe/ose të plotësuara kohë pas kohë nga Rregullatori;
  - (b) Të ofrojë rregullisht dhe pa përjashtim Faturat për të gjithë Konsumatorët që shfytëzojnë Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave;
  - (c) Të ofrojë raporte për Rregullatorin sipas kërkesave për shpalosjen e raporteve dhe informatave të përcaktuara nga Rregullatori kohë pas kohe;
  - (d) Të grumbullojë, largojë dhe transportojë Mbeturinat e Ngurta Komunale të cilat janë prodhuar dhe nxjerrur brenda Zonës së Shërbimit;
  - (e) Të grumbullojë, largojë dhe transportojë vetëm Mbeturinat e Ngurta Komunale të lejuara me Licencën e Shërbimit;
  - (f) Të transportojë Mbeturinat e Ngurta Komunale të grumbulluara vetëm në Kompleksin e Deponisë së Licencuar të aprovuar ose të Licencuar nga Rregullatori.
- 37.2 Nga Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave gjithashtu do të kërkohet të paguajë Rregullatorit Taksën Vjetore për Licencë e cila do të përcaktohet si në vijim:
- (a) Rregullatori në konsultim me Kuvendin e Kosovës, Ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, do të përcaktojë shumën e Taksës Vjetore për Licencë të pagueshme si në vijim të këtij Neni;
  - (b) Taksa Vjetore për Licencë e caktuar me datë dhe e pagueshme nga Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave për Rregullatorin nuk duhet të tejkalojë një e gjysmë përqind (1.5%) të qarkullimit bruto të raportuar nga Ofruesi i Shërbimit për Mbeturina të Ngurta në kontot e audituara të fitimit ose të humbjes; dhe
  - (c) Taksa Vjetore për Licencë duhet të vendoset duke u bazuar në shpenzimet të cilat Rregullatori i parasheh që do të shkaktohen në lidhje me lëshimin dhe monitorimin e Licencave të Shërbimit, siç janë të prezantura në planin vjetor të veprimit apo në buxhetin vjetor të përgatitur nga Rregullatori për vitin kalendarik në të cilin ajo Taksa Vjetore për Licencë bëhet e maturuar dhe e pagueshme.
- 37.3 Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të paguajë Taksën Vjetore për Licencë në dymbëdhjetë (12) këste të barabarta të Rregullatori, ku kësti i parë është i pagueshëm në ditën e parë të punës së muajit në vazhdim të datës në të cilën Licenca e Shërbimit është lëshuar ose e ripërtërirë për Ofruesin e Shërbimit dhe mëpastaj secili këst pasues do të jetë i maturuar në ditën e parë të punës të secilit muaj.

## **PJESA 5: REFUZIMI I LICENCËS SË SHËRBIMIT**

Neni 38 : Refuzimi për të lëshuar ose përtrirë Licencën e Shërbimit

- 38.1 Rregullatori do të refuzojë të bëjë aprovimin e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit ose të përtërijë Licencën e Shërbimit nëse:
- (a) Aplikuesi për Licencë të Shërbimit dështon të ofrojë informatat e kërkuara brenda kufijve të caktuar kohor;
  - (b) Një vlerësim i cili shpie në përfundim se Aplikuesi për Licencë të Shërbimit nuk mund të ofrojë Shërbim për Grumbullimin e Mbeturinave në nivel të kërkuar me Standardet e Shërbimit me një besueshmëri dhe siguri të kërkuar;
  - (c) Aplikuesi i Licencës së Shërbimit dështon të sigurojë autorizimet e nevojshme ose Licencat specifike nga autoritetet tjera kompetente të kërkuara me Rregullore;
  - (d) Për arsye tjera të justifikueshme që mund të specifikohen në Kushtet e Licencimit të Shërbimit.
- 38.2 Nëse Regullatori refuzon të lëshojë ose përtërijë Licencën e Shërbimit, i njëjti duhet të informojë me shkrim Aplikuesin e Licencës së Shërbimit në afat prej dhjetë (10) ditëve të punës, duke i dhënë arsyet për një vendim të tillë.

## **PJESA 6: PËRTËRIRJA DHE TRANSFERI I LICENCËS SË SHËRBIMIT**

### **Kapitulli 1: Përtërirja ose Transferi i Licencës së Shërbimit**

#### Neni 39 : Përtërirja e Licencës së Shërbimit

- 39.1 Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të aplikojë për përtërirjen e Licencës së Shërbimit së paku dy (2) muaj para datës kur skadon afati i Licencës së Shërbimit.
- 39.2 Aplikacioni për përtërirjen e Licencës së Shërbimit duhet të bëhet në formularin e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit të nxjerrun nga Rregullatori dhe sipas procedurave të dala nga kjo Rregull ose sipas përmirësimeve dhe/apo plotësimeve nga Regullatori të bëra kohë pas kohe.
- 39.3 Rregullatori duhet të përtërijë Licencën e Shërbimit për Aplikuesin e suksesshëm të Licencës së Shërbimit brenda tridhjetë (30) ditëve të punës nga data në të cilën është kompletuar shqyrtimi i detajizuar (teknik) dhe rezultati i shqyrtimit është vlerësuar si i pranueshëm sa i përket:
- (a) Pagesës së taksës së Aplikacionit për Licencë të Shërbimit;
  - (b) Plotësimin të kushteve të parashtruara në këtë Rregull lidhur me aplikimin për Licencë të Shërbimit;
  - (c) Demonstrimit se nëpërmes aplikimit për përtërirje të licencës janë përmbushur Kushtet Licencuese të Shërbimit nga Licenca e tij e mëparshme;
  - (d) Demonstrimit se të gjitha licencat, lejet, pëlqimet dhe autorizimet tjera të nevojshme nga të gjitha autoritetet kompetente do të jenë të vlefshme për kohëzgjatjen që është e barabartë me ose që tejkalon periudhën kohore për të cilën është përtërirë Licenca e Shërbimit; dhe

- (e) Kërkesave tjera të kësaj Rregulle që mund të jenë të aplikueshme.

Neni 40 : Transferi i Licencës së Shërbimit

Licenc e Shërbimit e lëshuara nën këtë Rregull nuk do të transferohen ose ti ipen palës së tretë pa pëlqimin me shkrim nga Rregullatori.

**PJESA 7: NDRYSHIMET, PËRFUNDIMI DHE REVOKIMI I LICENCËS SË SHËRBIMIT**

**Kapitulli 1: Ndryshimet, Plotësimet ose Zëvendësimet në Kushtet e Licencës së Shërbimit**

Neni 41 : E drejta e Rregullatorit të Ndryshojë, Plotësojë ose të Zëvendësojë Kushtet e Licencës së Shërbimit

Rregullatori mundë të ndryshoj, përmirësojë, plotësojë ose zëvendësojë cilatdo pjesë të Licencës së Shërbimit pas shqyrtimit të tyre dhe ta njoftoj me shkrim të paku tridhjetë (30) ditë të punës Ofruesin e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave. Njoftimi i tillë duhet të deklarojë natyrën, shkallën dhe kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve, plotësimeve ose zëvendësimeve të tilla në Kushteve të Licencës së Shërbimit.

Neni 42 : Shqyrtimi i Kualifikimeve të Drejtorit Menagjues

- 42.1 Rregullatori do ta shqyrtoj kualifikimin dhe përvojën e Drejtorit Menagjues i cili është tjetër person nga ai i përmendur në Aplikacionin për Licencë të Shërbimit, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve, duhet të dërgoj te Rregullatori kopjen e biografisë së Drejtorit Menagjues të propozuar që në mënyrë të detajizuar tregon arsimimin, përvojën e punës, zotimin e gjuhëve, përgaditjet tjera dhe aftësitë përkatëse për atë pozitë (Shtojca II).
- 42.2 Rregullatori pasi të shqyrtojë kualifikimet dhe përvojën e Drejtorit Menagjues të propozuar për të u siguruar në kompetencën teknike të tij dhe duhet të i përgjigjet me shkrim Bordit të Drejtorëve i cili ka dorëzuar kërkesën për emërimin e Drejtorit Menagjues, brenda 10 ditëve të punës nga data në të cilën Rregullatori ka pranuar dokumentet që referohen në nën-nenin 42.1
- 42.2. Rregullatori brenda 10 ditëve të punës nga data e pranimit të dokumentit që referohet nën nenin 42.1 duhet të i përgjigjet me shkrim Bordit të Drejtorëve, pasi të shqyrtojë kualifikimet dhe përvojën e Drejtorit Menagjues të propozuar për të u siguruar në kompetencën teknike të tij.

Neni 43 : Informimi i Rregullatorit për ndryshime të rëndësishme

- 43.1 Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të informojë me shkrim apo në formatin të cilin mund ta specifikojë Rregullatori kohë pas kohe për cilindo ndryshim të rëndësishëm nga detajet e parashtruara ose të bashkangitura të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit në afatin prej pesë (5) ditë të punës pas shfaqjes së ndryshimit

- 43.2 Rastet në vijim pa kufizime konsiderohen se përbëjnë ndryshim të rëndësishëm për Ofruesin e Shërbimit për Grumbullimn e Mbeturinave të paraqitura në Aplikacionin për Licencë të Shërbimit:
- (a) Ndryshimet e rëndësishme të bëra ose anulimet, pezullimet ose refuzimet e dhënies ose përtëritjes të cilësdo leje, pëlqimit ose autorizimit të marrë nga agjensionet tjera dhe/ose autoriteteve kompetente;
  - (b) Zgjerimi ose zvogëlimi i rëndësishëm i kapaciteteve të Kompleksit të shfrytëzuara për ofrimin e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave;
  - (c) Ndryshimet e rëndësishme të fushëveprimit në Zonën e Shërbimit;
  - (d) Ndryshimet e rëndësishme në pozitën ekonomike dhe financiare të Ofruesit të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave;
  - (e) Zvogëlimi ose rritja e rëndësishme në pasuritë dhe/ose detyrimet e Ofruesit të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave;
  - (f) Ndryshimet në pronësinë efektive dhe/ose kontrollin e menagjimit të Ofruesit të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave.

## **Kapitulli 2: Përfundimi, Revokimi ose Dorëzimi i Licencës së Shërbimit**

### Neni 44 : Përfundimi i Licencës së Shërbimit

Licenca e Shërbimit duhet të përfundojë në:

- (a) Datën e fundit të periudhës për të cilën është lëshuar;
- (b) Datën në të cilën Licenca e Shërbimit është revokuar nga Rregullatori;
- (c) Datën në të cilën Licenca e Shërbimit është dorëzuar.

### Neni 45 : Revokimi i Licencës së Shërbimit

- 45.1 Rregullatori mund të revokojë Licencën e Shërbimit konform Ligjit mbi Veprimtarit e Ofruesve të Shërbimit të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave e datës 15 Qershor 2008, Neni 7.
- 45.2 Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave të cilit i është revokuar Licenca e Shërbimit, mund të ankohet ndaj vendimit të Rregullatorit në pajtim me Ligjin Nr.03/L-086 e datës 15 Qershor 2008, mbi Veprimtarit e Ofruesve të Shërbimit të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave Neni 46 :

### Neni 46: Dorëzimi i Licencës së Shërbimit

- 46.1 Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave mund të dorëzojë Licencën e Shërbimit pasi të ketë njoftuar me shkrim Rregullatorin gjashtë (6) muaj më herët.
- 46.2 Njoftimi me shkrim i kërkuar në vijim të Nenit 46.pika1 duhet të nënshkruhet nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorve të Ofruesit të Shërbimit i cili ka vendos të dorëzojë Licencën.

## **PJESA 8: MARRËVESHJA PËR KUSHTET E LICENCËS SË SHËRBIMIT**

### Neni 47 : Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit

- 47.1 Rregullatori mund të lidhë marrëveshje me shkrim me Ofruesve të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave me qëllim të ndryshimit, zavendësimit dhe/ose plotësimit të cilatdo Kushteve të Licencës së Shërbimit të krijuara nën këtë Rregull
- 47.2 Në Marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimit mund të hyhet nëse janë dhënë cilatdo kushte pararendëse të përcaktuara nga Rregullatori dhe të propozuara për Ofruesin e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave, duke përfshirë, pa u kufizuar, hyrjen në marrëveshje tjera obliguese që lidhen me Ofruesin e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave mbi:
- (a) Vendosjen, shqyrtimin dhe/ose ndryshimin e cilatdo prej Standardeve të Shërbimit;
  - (b) Vendosjen, shqyrtimin dhe/ose ndryshimin e tarifave të Shërbimit;
  - (c) Zgjerimin apo zvoglimin e fushëveprimit të Zonës së Shërbimit;
  - (d) Vendosjen, ndërrimin, zgjerimin, modifikimin dhe/ose plotësimin e cilësdo dispozitë që ka të bëjë me Konsumatorë e që janë të paraqitura në Rregullin mbi Kartën e Konsumatorëve e lëshuar, ndryshuar, modifikuar dhe/ose plotësuar nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 47.3 Kushtet e Licencës së Shërbimit si objekt i Marrëveshjeve për Kushtet e Licencës së Shërbimit, në asnjë rast nuk duhet të jenë më pak strikte apo të ken më pak kërkesa se sa Kushtet e Licencës së Shërbimit të vëna nën këtë Rregull të ndryshuara dhe/ose të plotësuara nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 47.4 Për mënjanimin e çdo dyshimi, Ofruesit e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave kanë të drejtë por nuk janë të obliguar të i propozojnë Rregullatorit lidhjen e Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit në pajtim me dispozitat e Nenit 51 si më poshtë.

Neni 48 : Negociatat e Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit

- 48.1 Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave që dëshiron të hyjë në Marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimit duhet të dorëzojë Rregullatorit kërkesën me shkrim me të cilën kërkon hapjen e negociatave për të hyrë në një marrëveshje të tillë duke i mbështetur arsyet se pse ata konsiderojnë se interesi publik dhe të drejtat e tyre legjitime si dhe pritjet ligjore do të shërbeheshin më miri nëse Rregullatori do të pranojë të hyjë në Marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimit.
- 48.2 Rregullatori duhet të jep përgjigje me shkrim brenda pesë (5) ditëve të punës nga data e pranimit të Kërkesës të referuar në nenin 48. pika 1 , duke u pajtuar apo/ose refuzuar të hyjë në negociata nëMarrëveshjen për Kushtet e Licencës së Shërbimit ..
- 48.3 Nëse Rregullatori vendosë të refuzojë të fillojë negociatat për të lidhur Marrëveshjen për Kushtet e Licencës së Shërbimit, duhet të ofrojë arsyet e veta lidhur me refuzimin.
- 48.4 Nëse Rregullatori pajtohet të fillojë negociatat për të hyrë në Marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimit, gjithashtu Ofruesit të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave i jepet një periudhë të arsyeshme kohore jo më pak se (30) tridhjetë

ditë të punës, për ti parashtruar Rregullatorit Propozimin e Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit.

- 48.5 Brenda dhjetë (10) ditëve të punës prej marrjes së draftit (Propozimit) të Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit, Rregullatori duhet të njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave në lidhje me caktimin e takimit të parë për të filluar me negociatat për marrëveshjen.
- 48.6 Gjithashtu Rregullatori mund të përcaktojë periudhën kohore maksimale për përfundimin e negociatave për hyrje në Marrëveshjen për Kushtet e Licencës së Shërbimit, e cila nuk mund të jetë më pak se njëzet (20) ditë të punës nga data e caktimit të takimit të parë në pajtim me nën-nenin 48.5 të lartëshënuar.
- 48.7 Për mënjanimin e çdo dyshimi, Rregullatori ka të drejtë por nuk është i obliguar të lidhë Marrëveshjen për Kushtet e Licencës së Shërbimit, dhe në rast të refuzimit apo të dështimit të suksesshëm të negociatave të përmendura konsiderohet si vendime kontraktuese dhe jo si akte administrative ose vendime që i nënshtrohen cilitdo shqyrtim administrativ dhe/ose juridik.

#### Neni 49 : Lidhja e Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit

- 49.1 Në rast të përfundimit të suksesshëm të negociatave të zhvilluara në pajtim me Nenin 48, Rregullatori dhe Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave do të lidhin me shkrim Marrëveshjen për Kushtet e Licencës së Shërbimit.
- 49.2 Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit duhet të nënshkruhet në tri versione në secilën prej gjuhëve që janë në përdorim në Kosovë si në vijim:
- (a) Shqip;
  - (b) Sërbisht
  - (c) Anglisht.
- 49.3 Në rast të mospërputhjes ndërmjet cilitdo version në të cilin është nënshkruar Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit, versioni në gjuhën Shqipe do të mirret si bazë.
- 49.4 Përveç nëse informata dhe/ose dokumenti mund të konsiderohet që përmbanë cilëndo informatë të privilegjuar ose të besueshme që Rregullatori mund ta mbështes nëpërmes vendimit me shkrim, Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit, shtojcat e saj dhe të gjitha informatat e përdorura për negociatave dhe hyrja në atë marrëveshjeje duhet të publikohen apo të bëhen publike me mjetet të cilat Rregullatori mund të i përcaktojë kohë pas kohe dhe të i vë në dispozicion në çdo kohë për konsultim publik.
- 49.5 Ciliatdo ndryshime, zavendësime, modifikime ose dispozita plotësuese përkitazi me Marrëveshjet për Kushtet e Licencës së Shërbimit duhet të kërkojnë pëlqimin e të dyja palëve, Rregullatorit dhe të Ofruesit të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave dhe të publikohen në pajtim me dispozitën e nenit 49.4..

#### Neni 50 : Karakteri Ligjor dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit



- 50.1 Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit konsiderohet si kontratë administrative për të gjitha qëllimet ligjore të synuara duke bërë Rregullatorin të obliguar të bejë negociata, të hyjë në një marrëveshje të tillë dhe ta ekzekutojë atë me respektim të përpikët të parimeve të përgjithshme ligjore, rregullave dhe procedurave që drejtojnë ushtrimin e të drejtave të posaçme dhe detyrave të autoriteteve publike.
- 50.2 Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit, si akt ligjor bilateral, legalisht është detyrues, imponues dhe i zbatueshëm në pajtim me kushtet e veta për të dyja palët dhe mund të, përmirësohet, zgjerohet, ndryshohet, plotësohet, shqyrtohet dhe/ose të ndërpritet vetëm nga pikëpamja e dispozitave të tija dhe ligjit të aplikueshëm në Kosovë.

#### Neni 51: Pajtueshmëria me Kushtet e Licencës së Shërbimit

Ofruesit e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave janë të obliguar të respektojnë dhe të iu përmbahen Kushteve të Licencës së Shërbimit të vendosura në kushtet e përgjithshme në këtë Rregull:

- (a) Përderisa negociatat për të hyrë në Marrëveshjen për Kushtet e Licencës së Shërbimit janë të pezulluara deri në datën e hyrjes në fuqi të asaj Marrëveshjeje;
- (b) Menjëherë pas ndërprerjes, anulimit, revokimit dhe/ose skadimit të Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit përderisa cilado e drejtë dhe obligim që përmban Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit nuk bie në dakord për të mbijetuar kur të ndërpritet të jetë plotësisht në fuqi dhe efekt për çfarëdo shkak ligjor;
- (c) Në çdo pikëpamje kur Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit nuk përcaktohet ndryshe dhe/ose kur nuk parashihet në mënyrë të veçantë në një Marrëveshje të tillë.

### **PJESA 9: ZBATIMI, DËNIMET DHE ANKESAT**

#### **Kapitulli 1: ZBATIMI i Kushteve të Licencës së Shërbimit**

##### Neni 52 : Zbatimi i Kushteve të Licencës për Shërbimit

- 52.1 Rregullatori duhet të monitorojë respektimin e Kushteve të Licencës së Shërbimit të vendosura në këtë Rregull në bazë të raporteve të rregullta të dërguara nga Ofruesit e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave kohë pas kohë siç përcaktohet nga Rregullatori në pajtim me Nenin 53 të shënuar mëposhtë.
- 52.2 Rregullatori gjithashtu duhet të monitorojë përmbushjen e kësaj Rregulle me anë të inspektimeve, analizave dhe nga raportet e dërguara nga entitetet tjera dhe autoritetet publike.

## **Kapitulli 2: Raportet dhe Shënimet për Kushtet e Licencës për Shërbimit**

### Neni 53: Shënimet dhe raportet për Kushtet e Licencës së Shërbimit

- 53.1 Secili Ofrues i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të përgatisë dhe të parashtojë raporte te Rregullatori në formën e përshkruar dhe brenda intervaleve të specifikuar nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 53.2 Secili Ofrues i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave duhet ta dorzojë Rregullatorit Raportin Vjetor, jo më vonë se 30 Prilli vitit kalendarik në vazhdim nga përfundimi i vitin të mëparshëm, në formatine pëcaktuar kohë pas kohe nga Rregullatori.
- 53.3 Secili Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet ti dorëzojë Rregullatorit një raport mujor të performancës, jo më vonë se më datën 20 të çdo muajit vijues, në formatin e përcaktuar nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 53.4 Raportet financiare teemujore të paadituara duhet dorëzohen në ditën e 15-të të muajit në vazhdim të muajit Mars, Qershor, Shtator dhe Dhjetor Në FORMATIN Që Është në përputhje me standardet e pranuar të llogaritjes dhe rregullave që janë në fuqi në Kosovë
- 53.5 Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë të punës nga data kur ka ndodhur cilido ndryshim material në cilindo fakt ose informatë që përmban dokumenti i cili e ka shoqëruar Aplikacionin për Licencë të Shërbimit, Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të dërgojë një version me të dhënat e fundit në formatin të cilin mund ta specifikojë Rregullatori kohë pas kohe ose me anë të komunikimit me shkrim.
- 53.6 Ofruesit e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të njoftojnë me shkrim Rregullatorin për cilatdo fakte ose situata të cilat kanë ngjarë dhe kanë prodhuar situatën në të cilën Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave të mos jetë më në gjendje të përmbush dhe/ose ka dështuar të përmbush kushtet dhe konditat të atyre lejeve zyrtare, autorizimeve ose pëlqimeve nga autoritetet tjera kompetente, të konsideruara si esenciale për dhënien e Licencës së Shërbimit në pajtim me këtë Rregull
- 53.7 Ofruesit e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave janë të obliguar ti raportojnë me shkrim te Rregullatori cilatdo fakte ose situata të cilat aktualisht ose potencialisht mund të ndikojnë në pozitën e tyre ekonomike dhe financiare dhe/ose solvenitetin, kapacitetin e tyre Menagjues për të ofruar Shërbimin për Grumbullimin e Mbeturinave dhe/ose disponueshmërinë aktuale të ekspertizës teknike dhe të resurseve të kërkuara për dhënien e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave me standardet e përcaktuara nga Rregullatori, duke përfshirë pa kufizime sa herë që:
- (a) Cilido interes i sigurisë mbi asetet që janë të qenësishme për ofrimin e Shërbimit për Grumbullimit e Mbeturinave bëhet i detyrueshëm;
  - (b) Cilido person merr posedimin mbi, apo cilido proces mbahet, imponohet apo ngrehet padija ndaj cilitdo aseti që është i qenësishëm për ofrimin e Shërbimit për Grumbullimit e Mbeturinave;
  - (c) cilido hap dhe/ose cilado mënyrë e veprimit ligjor ka filluar ose cilatdo hapa tjerë janë ndërmarrë për të bankrotuar ose likuiduar Ofruesin e Shërbimit për

- (d) Grumbullimin e Mbeturinave ose për ta shpallur atë jo solvent.
- 53.8 Gjitha shënimet duhet të mbahen në selinë e Ofruesit të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave dhe duhet të jenë në dispozicion gjatë orarit të rregullt të punës për kontrollim nga Rregullatori.
- 53.9 Gjitha shënimet dhe raportet e parapara në këtë Nen duhet të organizohen dhe të mbahen nga Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave së paku 2 (dy) vite kalendarike nga data kur ato janë përgatitur së pari ose u është caktuar afati, përveç nëse ndonjë ligj tjetër i aplikueshëm e përcakton se ato duhet të mbahen për cilëndo periudhë më të gjatë kohore në të cilin rast periudha e fundit e mbajtjes duhet të aplikohet.

### **Kapitulli 3: Kundërvajtjet dhe Dënimet**

#### Neni 54: Kundërvajtjet dhe Dënimet

- 54.1 Dështimi për të përmbushur gjatë gjithë kohës cilën do prej Kushteve të Licencës së Shërbimit të përcaktuara nën këtë Rregull përbën kundërvajtje dhe do të ndëshkojë Ofruesin e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave kundërvajtës me gjobë të vënë në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-086 e datës 15 Qershor 2008, mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave.
- 54.2 Gjjobat për shkelje të cilës do prej Kushteve për Licencë të Shërbimit gjithashtu do të caktohen në pajtim me procedurat e përcaktuara nën këtë Rregull mbi vënien e gjjobave dhe me cilatdo Rregulla tjera procedurale të përcaktuara nga Rregullatori kohë pas kohe.

### **Kapitulli 4: Ankesat**

#### Neni 55: Ankesat

- 55.1 Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave mund të ankohet te Komisioni i Shqyrtues i themeluar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-086 të datës 15 Qershor 2008, mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimit të Ujësjellësi, Kanalizimit dhe të Mbeturinave ndaj cilitdo vendim konkret të Rregullatorit të ndërmarr për cilatdo çështje relevante, duke përfshirë pa kufizime,:
- (a) Dhënien, ndërrimin, modifikimin, ndryshimin, plotësimin, ripërtërirjen, zgjerimin dhe/ose modifikimin e Licencës së Shërbimit;
  - (b) Revokimin, deklarimin e përfundimit dhe/ose pezullimin e cilësdo Licencë të Shërbimit të parapara nën këtë Rregull;
  - (c) Vendosja dhe/ose zbatimi i cilitdo Kusht të Licencës së Shërbimit të paraparë nën këtë Rregull;
  - (d) Vënia e gjjobave për cilëndo shkelje të Kushteve të Licencës së Shërbimit dhe/ose për shkeljen e cilësdo dispozitë të kësaj Rregulle.
- 55.2 Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave gjithashtu mund të ankohet në gjykatat e Kosovës ndaj vendimit të Komisionit të Shqyrtues të marra për ndonjë veprim apo çështje konkret për sa i përket zbatimit të kësaj Rregulle në pajtim Ligjin

Nr.03/L-086 te datës 15 Qeshor 2008, mbi Veprimtarir e Ofruesve të Shërbimit të Uësjellësi, Kanalizimit dhe të Mbeturinave referuar Nenit 35.

55.3

55.4 Nxjerrjes të cilitdo vendim konkret për zbatimin e kësaj Rregulle, Rregullatori duhet të informojë Ofruesin e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave të cilit i adresohet vendimi për të drejtën e tij për ankesë në pajtim me këtë Nen.

## **PJESA 10: TË NDRYSHME**

### Neni 56 : Gjuhët

56.1 Kjo Rregull lëshohet dhe publikohet në tri versione të shkruara në gjuhët që përdoren në Kosovë:

- (a) Shqip,
- (b) Sërbisht dhe
- (c) Anglisht

56.2 Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të versioneve në të cilat ky Rregull është lëshuar, versioni në gjuhën Shqpie do të mirret si bazë.

### Neni 57 : Hyrja në Fuqi

57.1 Kjo Rregull do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë kalendarik pas datës së nënshkrimit.

---

**Afrim Lajci**  
**Drejtor I ZRRUM-it**

**SHTOJCAT**

## SHTOJCA 1

### *FORMULARËT DHE DOKUMENTET*

Licenca e Shërbimit për Ofruesit e Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave të Ngurta në Kosovë

Format dhe dokumentet në vijim janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

- (a) Shtojca 1(a): Formulari i Aplikacionit për Licencë të Shërbimit;
- (b) Shtojca 1(b): Formulari i listës së paisjeve për Grumbullimin, Transportimin e Mbeturinave dhe Paisjet për Mirëmbajtje;
- (c) Shtojca 1(c): Autorizimi i Bordit të Drejtorve
- (d) Shtojca 1(d): Aprovimi i Deklaratave Financiare;
- (e) Shtojca 1(e): Letra Konfirmuese nga Komuna;
- (f) Shtojca 1(f): Letra Autorizuese nga Komuna për Hudhjen e Mbeturinave të Ngurta Komunale të grumbulluara;
- (g) Shtojca 1(g): Lista Kontrolluese e Kompletueshmërisë Administrative për Aplikacionin e Licencës së Shërbimit;
- (h) Shtojca 1(h): Çertifikata e Licencës së Shërbimit;
- (i) Shtojca 1(i): Formatimi për Biografite
- (j) Shtojca 1(j): Licenca e Shërbimit.

**Shtojca 1(j) do të përgatitet dhe dorëzohet ndaras. Kjo shtojcë përbëhet prej shabllonit të dokumentit të kompletuar për Liçensë të shërbimit.**

**SHTOJCA 1(A)**  
**FORMULARI I APLIKACIONIT PËR LICENCË TË SHËRBIMIT**

ME KËTË FORMULAR APLIKOHET TE ZYRJA E RREGULLATORIT PËR UJË DHE MBETURINA, PËR LICENCË TË SHËRBIMIT PËR TË OFRUAR SHËRBIMIN E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE. NJOFTOJMË SE OFRIMI I INFORMATËS SË PASAKTË MUND REZULTOI NË REFUZIMIN E LICENCËS SË SHËRBIMIT

KJO KËRKESË DUHET TË DËRGOHET TE:	VETËM PËR SHFRYTËZIM ZYRTAR								
<b>ZYRJA E RREGULLATORIT PËR UJË DHE MBETURINA NDËRTESTA E BARDHË, Rruga BAJRAM KELMENDI PRISHTINË, KOSOVË</b>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 80%;">Data e Pranimit</td> <td style="width: 20%;"></td> </tr> <tr> <td>Data e Marrjes</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Data e Refuzimit</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Taksa e paguar për Kërkesë për Licencë të Shërbimit</td> <td style="text-align: right;"> <input type="checkbox"/> Po  <input type="checkbox"/> Jo                 </td> </tr> </table>	Data e Pranimit		Data e Marrjes		Data e Refuzimit		Taksa e paguar për Kërkesë për Licencë të Shërbimit	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
Data e Pranimit									
Data e Marrjes									
Data e Refuzimit									
Taksa e paguar për Kërkesë për Licencë të Shërbimit	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo								

PJESA 1 - IDENTIFIKIMI I APLIKUESIT PËR LICENCË TË SHËRBIMIT			
<b>(a) Emri</b>			
<b>(b) Adresa</b>			
<b>(c) Numri i telefonit kryesor</b>		<b>(d) Numri i telefonit mobil</b>	
<b>(e) Numri i faksit</b>		<b>(f) Adresa elektronike (E-mail)</b>	
PJESA 2 – KONTAKT PERSONI I APLIKUESIT PËR LICENCË TË SHËRBIMIT			
<b>(a) Emri i kontakt personit</b>			
<b>(b) Titulli dhe funksioni</b>			
<b>(c) Numri i telefonit të zyres</b>		<b>(d) Numri i telefonit mobil</b>	
PJESA 3 – MENAGJERËT E LARTË			
<b>(a) Emri i Kryesuesit të Bordit Mbikqyrës (ose Kryesuesit të Bordit)</b>			
<b>(b) Emri i Drejtorit Menagjues (ose Drejtorit Kryesor)</b>			
<b>(c) Emri i Zyrtarit të Lartë Financiar (ose ekuivalent)</b>			
<b>(d) Emri i Menagjerit të Lartë Operativ (ose ekuivalent)</b>			
PJESA 4 – OFRUESIT E BASHKUAR E SHËRBIMIT PËR GRUMBULLIMIN E MBETURINAVE			
